MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

E lidhur dhe efektive nga sot, datë 17.06.2021 në Prishtinë, ndërmjet:

"KOLEGJI UNIVERSUM" O.P., kompani e regjistruar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me numër unik identifikues 810640294, me seli të regjistruar në Ferizaj, Adresa Rr."Fan Noli", Nr.156, Republika e Kosovës, përfaqësuar ligjërisht nga z. Suat Berisha, në cilësinë e Drejtorit (referuar këtu më poshtë si "*Kolegji*").

dhe

"SPITALI SIRONA". kompani e regjistruar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, me numër unik identifikues 70801019 me seli të regjistruar në Rr. Prishtinë-Shkup Selenicë, Prishtinë, Republika e Kosovës, përfaqësuar ligjërisht nga Ramadan Sejdiu në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv (referuar këtu më poshtë si *"Institucioni Shëndetësor"* dhe/ose *"Spitali"*).

Preambulë;

DUKE QENË SE "Spitali Sirona", me të dhënat e tjera si në krye të kësaj Marrëveshje, është institucion shëndetësor i licencuar si Spital Special ofron dhe mundësinë e kryerjes së punës praktike për studentë dhe profesionistë të lëmive të ndryshme;

DUKE QENË SE "Kolegji" me të dhënat e tjera si në krye të këtij Memorandumi, përveç mundësisë së studimeve, përfshirë këtu edhe studimet për infermieri, dëshiron që, t'u ofrojë studentëve mundësinë e kryerjes së punës praktike tek Spitali, sipas kushteve dhe termeve të përcaktuara;

PRANDAJ, palët kontraktuese u morën vesh me sa vijon:

NENI 1

Ky Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim te ndërsjelle (tash e tutje referuar si "Memorandumi"), e lidhur ndërmjet institucioneve të lartpërmendura, ka për qëllim avancimin e shërbimeve profesionale-edukative, duke përfshirë zhvillimin e programeve akademike dhe joakademike për trajnim, me fokus të veçantë në fushën e infermierisë.

NENI 2

2.1. Me anë të këtij Memorandumi, palët dakordohen që Spitali do t'u mundësoj studentëve të Kolegjit kryerjen e punës praktike tek Spitali, sipas kushteve të përcaktuara dhe bazuar në kontratat për internship që Spitali do të lidh me secilin studentë veç e veç.

2.2. Studentët e Kolegjit janë të obliguar t'i përmbahen rregullave të sjelljes dhe të punës në Spital, të mbajnë rendin dhe qetësinë dhe mos të pengojnë procesin e punës në Spitalin Sirona gjatë ndjekjes së praktikës, si dhe të tregojnë vëmendje e kujdes të shtuar gjatë përdorimit të pajisjeve e mjeteve të punës.

2.3. Spitali obligohet që të lejojë dhe të përkrahë ushtrimin e pjesës praktike të studentëve të Kolegjit sipas orarit i cili është dorëzuar dhe miratuar mes palëve dhe plan-programit studimor të Kolegjit.

2.4. Në këtë marrëveshje, palët kontraktuese dakordohen për orarin e ushtrimeve, bazuar në plan-programin e studimeve, i cili do të dorëzohet Spitalit në çdo fillim semestri. Në fillim të çdo semestri, palët me marrëveshje do të dakordohen për numrin e studentëve që mund të kryejnë praktikë në Spitalin Sirona, bazuar në kushtet dhe mundësitë logjistike që i posedon Spitali. Me këtë rast, Kolegji do të dorëzoje pranë Spitalit listën e studentëve, me të dhënat e tyre personale (Aneksi I).

2.5. Palët kontraktuese delegojnë përgjegjësitë teknike tek personat e autorizuar të dy institucioneve duke prioritizuar mbarëvajtjen e papenguar të punëve në spital si interes i dyanshëm.

2.6. Palët pajtohen se për çdo dëm që do ta shkaktojnë studentët e Kolegjit gjatë kryerjes së praktikës, dëm ky që mund t'i shkaktohet Spitalit dhe/ose personave të tretë në lidhje me Spitalin, Kolegji do të jetë përgjegjës për kompensimin e atij dëmi.

NENI 3

Përveç marrëveshjes për kryerjen e punës praktike, me anë të kësaj Marrëveshjeje, Spitali Sirona dhe Kolegji bien dakord që shqyrtojnë mundësitë për hartimin dhe zbatimin e projekteve, ideve, programeve dhe aktiviteteve në fusha të ndryshme të bashkëpunimit, si:
3.1. Mbështetja dhe avancimi i studentëve përmes monitorimit të praktikave, me fokus në hapësirën infermierore në Kosovë, përmes bashkëpunimit dhe bashkërenditjes së aktiviteteve të parapara në programet arsimore;
3.2. Mbështetje, zhvillim dhe përmirësim i sistemit të edukimit profesional, atij universitar dhe pasuniversitar në lëmitë shëndetësore, në bashkëpunim e bashkëveprim me institucionet përkatëse të arsimit dhe integrimit teori-praktike;
3.3. Nxitja dhe lehtësimi i bashkëpunimit ndërdisiplinor;
3.4. Organizim të trajnimeve me tematikë të ndryshme të karakterit shkencor dhe kualifikues;
3.5. Mbështetja dhe promovimi i mirëqenies përmes aktiviteteve integruese dhe multidisiplinare;
3.6. Bashkëpunim në projektet nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare;
3.7. Bashkëpunim në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare në hapësirat e shkencave të shëndetësisë dhe infermierisë;
3.8. Realizimi i përbashkët i simpoziumeve, konferencave dhe aktiviteteve të tjera shkencore;
3.9. Përpilimi dhe realizimi i programeve të përbashkëta për karrierë dhe punësim në lëmit shëndetësore; dhe
3.10. Përpilimi dhe realizimi i përbashkët i programeve të mobilitetit me institucione vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

NENI 4

Çdo propozim për aktivitet duhet të aprovohet paraprakisht nga të dyja institucionet. Pasi të pranohet propozimi, të dy institucionet caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e aktivitetit.

NENI 5

Të dy institucionet mund të aplikojnë ndaras apo në formë të përbashkët për grante pranë organizatave apo institucioneve të ndryshme.

NENI 6

6.1. Marrëveshja lidhet për një periudhë prej 3 (tri) vitesh. Ajo hyn në fuqi nga data QERSHOR 2021 dhe është e vlefshme deri më SHTATOR 2023

6.2. Kjo marrëveshje do te përfundojë me përfundimin e afatit te përcaktuar ne ketë kontrate.

6.3. Palët kanë të drejtë të shkëpusin këtë marrëveshje nëse ndonjëra nga palët nuk i respekton dhe përmbush detyrimet kontraktuale sipas kushteve dhe afateve të parapara, dhe ky mosrespektim respektivisht mospërmbushje, i është bërë me dije palës tjetër 15 ditë paraprakisht, përmes një njoftimi me shkrim.

6.4. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet para afatit në rastet e forcave madhore, mbylljes së aktivitetit te parakohshëm të ndonjërës nga palët kontraktuese, si dhe ndryshimit të politikave të Spitalit.

6.5. Palët me marrëveshje të ndërsjelltë, mund ta përfundojnë këtë Marrëveshje në çdo kohë.

6.6. Secila palë ka të drejtë të shkëpusë njëanshëm këtë Marrëveshje duke i dhënë palës tjetër njoftim me shkrim 30 ditë paraprakisht, pa obligimin për të dhënë arsyet e shkëputjes.

NENI 7

7.1. Palët bien dakord që të gjitha komunikimet zyrtare ndërmjet tyre do të bëhen me shkrim, nëpërmjet dërgimit të shkresës përkatëse të firmosur prej një nga personat e përcaktuar më poshtë për secilën palë dhe të vulosur prej shoqërisë, me e-mail ose përmes postës, në numrat dhe adresat e mëposhtme:

Personat e Kontaktit për Spitalin Sirona:

Adresa postare:
MAG. PRISHTINË - SHKUP
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

1. ALBËRTË KRASNIQI
E-mail: hospitalsirona@gmail.com, albertakrasniqi@hotmail.com
Nr.Tel: 044 600 303, 045 544 839
Cel: _____

Personat e kontaktit për Kolegjin Universum O.P.

Adresa postare:
.....
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

1. .....
E-mail: .....
Nr.Tel: .....
Cel: .....

7.2. Çdo informacion i përcjellur nga njëra palë tek tjetra përmes telefonit, duhet të përcillet gjithashtu me email dhe/ose përmes adresës postare.

7.3. Për çdo ndryshim në personat e kontaktit palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim.

7.4. Komunikimet që do të jenë kryer në shkelje të dispozitave të këtij neni nuk do të konsiderohen të kryera.

NENI 8

Të gjitha informacionet e paraqitura në këtë marrëveshje duhet të konsiderohen konfidenciale. Palët bien dakord të mos shpërndajnë në mënyrë direkte, apo indirekte, këto informacione përkundrejt të tretëve, cilado qofë arsyeja.

NENI 9

Asnjëra nga palët nuk mban përgjegjësi për mosekzekutimin e plotë apo të pjesshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë kur kjo gjë ka ardhur si pasojë e forcave madhore ashtu siç parashikon ligji. Në këtë rast palët me mirëkuptim dhe miratim të përbashkët mund të caktojnë një afat tjetër të arsyeshëm për ekzekutimin e mëtejshëm të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

NENI 10

10.1. Ky Memorandum Mirëkuptimi është hartuar ne bazë të vullnetit dhe gatishmërisë për bashkëpunim ne mes dy palëve.

10.2. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij memorandumi, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet Palëve.

NENI 11

11.1. Ky Memorandum Mirëkuptimi si dhe Aneksi I i saj (Lista e studentëve të Kolegjit) përbëjnë të gjithë dhe të vetmen marrëveshje ndërmjet dy palëve dhe përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse të palëve siç janë kërkuar dhe tentuar.

11.2. Ky Memorandum si dhe ndonjë klauzolë mund të ndryshohet vetëm me miratimin e të dy palëve dhe ky miratim do të bëhet me shkrim. Ndryshimet e mëvonshme bashkëngjiten në formë aneksi.

11.3. Në rast të një papajtueshmërie ndërmjet dispozitave të memorandumit dhe anekseve të saj palët bien dakort që do të zbatohen dispozitat e reja mbi të vjetrat.

11.3. Ky Memorandum është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, dhe secila palë do të marrë nga një të tillë.

Për palët kontraktuese:

"SPITALI SIRONA"

z. RAMADAN [illegible]
Drejtor Ekzekutiv

KOLEGJI UNIVERSUM" O.P

z. Alejtin BERISHA
Drejtor Ekzekutiv

ANEKSI I

-Lista emërore e studentëve të "KOLEGJI UNIVERSUM" O.P

Nr.	EMRI	MBIEMRI	DATËLINDJA	NR. PERSONAL
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				